



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.1002/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Adnan Konushvci, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit F. H. nga P., Lagjja U., . Hyrja ., Nr. ., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Teuta Zhinipotoku, avokate nga Prishtina, Rruga “Nekibe Kelmendi”, Nr. 1, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Jeton Idrizi, avokat nga Prishtina, Rruga “Bill Clinton”, Hyrja 69, Kati -I-, Nr.1, me objekt kontesti dhënia e banesës, dhe duke vepruar sipas udhëzimeve që kanë rezultuar nga aktvendimi Ac.nr. 1108/2014 datë 19.03.2019, i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në seancën e mbajtur publike me datë 10.09.2020, në praninë e paditësi, përfaqësueses së tij dhe përfaqësuesit të paditurës, me datën 24.09.2020 jep këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET padia dhe kërkesëpadija e paditësit F. H. nga P., Lagjja U., . Hyrja ., Nr. ., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës, t’ia jap paditësit në posedim dhe pronësi një banesën me tri (3) dhoma në Prishtinë, në emër të banesës së rrënuar nga e paditura në vitin 1992, e cila ishte në Prishtinë, Rruga “...”, Nr. . dhe ./., që e kishte në shfrytëzim paditësi nga viti 1964, e deri në momentin e rrënimit, apo t’i bëhet kompensimi në të holla, për një banesë në Prishtinë, me sipërfaqe prej 85 m², bazuar në çmimin e tregut. Kompensimin e dëmit për mos shfrytëzimin e banesës dhe atë nga data 25.02.1994, e deri në vendosjen paditësit në banesën e re dhe shpenzimet e kësaj procedure, të gjitha këto në një afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si kërkesë e **pabazuar**.

A r s y e t i m

Paditësi nëpërmes përfaqësueses së tij ka ushtuar padi dhe kërkesëpadi në këtë gjykatë me datë 23.12.2002, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që gjykata ta detyrojë të paditurën që t’ia jap paditësit në posedim dhe pronësi një banesë me tri (3) dhoma në Prishtinë, në emër banesës së rrënuar nga e paditura, në vitin 1992, e cila ishte në Prishtinë, Rruga “...”, Nr. 62 dhe 62/A, që e kishte në shfrytëzim paditësi nga viti 1964, e deri në momentin e rrënimit, apo t’i bëhet kompensimi në të holla, për një banesë në Prishtinë, me sipërfaqe prej 85 m², bazuar në çmimin e tregut. Kompensimin e dëmit për mos shfrytëzimin e banesës dhe atë nga data 25.02.1994, e deri

në vendosjen paditësit në banesën e re. Mëtej paditësi përmes përfaqësues së tij, ka theksuar se bazuar në udhëzimet që kanë rezultuar nga aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr. 1108/2014 datë 19.03.2019, se nuk janë të legjitimuar proceduralisht palët ngase palës se paditur i mungon legjitimiteti pasiv, e njofton gjykatën se kjo çështje është e paqëndrueshme sepse pala e paditur e ka legjitimitetin e plotë ashtu siç e parasheh Ligji i Procedurës Kontestimore (LPK). Sipas paditësit ekziston raporti juridik në mes paditësit dhe të paditurës sepse me vendimin Nr. 468 te datës 13.11.1964 dhe me vendimin Nr. 653 te datës 18.10.1974, e paditura ka ndarë banesën dy dhomshe në emër të babait të paditësit, tani i ndier A. H., i cili ishte punëtor i Qendrës së Studentëve në Prishtinë. Kurse sa i përket kontiunitetit të Komunave të Kosovës para dhe pas Luftës, paditësi deklaroi se e njofton gjykatën se me Rregulloren e UNMIK, Nr.199/24 thuhet se Ligji i aplikueshëm në Kosovë, që kanë qenë në fuqi me datën 22 mars të viti 1989, ku me këtë rregullore është njohur kontiuniteti juridike që nënkupton se janë bartur të gjitha obligimet e organeve të para Luftës tek organet e krijuara pas Luftës. Me rregulloren e UNMIK-ut, Nr. 2000/60 sa i përket kërkesave pronësore dhe banesore në mënyrë decedive është rregulluar në tërësi kjo materie, ku në nenin 2 të saj parashihet si vijon: *“Çdo e drejtë në pronë që është fituar në mënyrë të drejtë në pajtim me ligjin në fuqi në kohën e fitimit të saj, mbete e vlefshme përkundër ndërrimeve në legjislacionin në fuqi të Kosovës, përveç në ato raste kur ajo Rregullore përcakton ndryshe”*. Çdo person i cili e ka humbur të drejtën në pronë në periudhën ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe datës 24 mars 1999 si pasojë e diskriminimit, ka të drejtë për kthimin e saj në pajtim me rregulloren. Rikthimi mund të jetë në formë të rivendosjes se të drejtës mbi pronë ose kompensim. Me propozim për gjykatën që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar

E paditur përmes përgjigjes në padi, shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet në tërësi pran deklarimeve të dhëna në seancat e kaluara si dhe parashtresën e dorëzuar në gjykatë të datës 19.06.2020. Paditësi nuk ka asnjë bazë të vlefshme juridike për fitimin e të drejtës së përhershme të banimit siç ka kërkuar, i njëjti që të detyrohet e paditura që t’ia japë në shfrytëzim një banesë tri dhomshe në Prishtinën pasi se Komuna e Prishtinës nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje juridike. Kjo për shkak se Komuna e Prishtinës është themeluar në bazë të Rezolutës së Kombeve të Bashkuar 1244, e miratuar me 10.06.1999 dhe sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë e cila ka hy në fuqi me 11 gusht 2000. Me të cilën rregullore, janë themeluar, institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes autonome dhe demokratike në nivel komunal, është bërë konstituimi i komunave, janë themeluar organet e saj, janë përcaktuar të drejtat dhe përgjegjësit e tyre, andaj në ndërmjet Komunës së Prishtinës e cila ka ekzistuar para intervenimit të NATO-së në Kosovës dhe komunës së konstituuar pas luftës nuk ekziston kontiuniteti dhe suksesioni juridik. Andaj kërkojmë nga gjykata që të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata, për ta vlerësuar drejtë dhe për të vërtetuar gjendjen faktike lidhur me çështjen juridike në shqyrtimin kryesor publikën të mbajtur me datën 10.09.2020, me propozimin e palëve ndërgjyqësve dhe sipas udhëzimeve që kanë rezultuar nga aktvendimi Ac.nr. 1108/2014 datë 19.03.2019, i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, ka bërë administrimin e provave të cilat janë administruar në seancën e datës 11.11.2013, të cilat janë: Kërkesa drejtuar Këshillit falimentues të Organizatës ..., për lirim të hapësirës për ndërtimin e Kishës Ortodokse Serbe, me Nr. 07-353/181 e datës 16.08.1992, Procesverbalin e Komisionit për shikimin e truallit ndërtimor i datës 07.10.1991, Vendimi i Sekretariatit komunal për urbanizëm dhe çështje banesore me Nr. 7-360-830 i datës 25.02.1994 i lëshuar nga Komuna e Prishtinës dhe Vendimi i sekretariatit komunal për çështje banesore, me Nr. 5/94 i datës 14.04.1998, i lëshuar nga Komuna e Prishtinës.

Gjykata, pasi që vlerësoi me ndërgjegjeje të kujdesshme provat e administruara, dhe atë ç' do provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësve **është e pa bazuar**, për këto arsye:

Në këtë rast gjykata vlerëson se banesa të cilën e kërkon paditësi, është rrënuar me qëllim të ndërtimit të kishës Ortodokse Serbe, e cila çështje nuk është kontestuese për palët ndërgjyqëse e as për gjykatën.

Kontestuese në këtë rast është e drejta e kërkesës së paditësit për t'iu ndarë një banesë në Prishtinë, si kompensim për banesën e rrënuar apo t'i kompensohet në të holla e njëjta nga e paditura.

Institucionet e atëhershme e kanë konstatuar në ato procesverbal të komisioneve, së paditësit duhet për t'ju dhënë një banesë nga Fondi Komunal i banesave, që i plotëson nevojat banesore të paditësit, banesën tri dhomshe, por e kanë konstatuar se përkohësisht i jepet një garsonjer në shfrytëzim paditësi, në sipërfaqe prej 24 m². Nga Vendimi me Nr. 07 i datës 04.12.1992, gjykata konstaton se paditësi është vendosur me datë 04.12.1992, për të jetuar, në Lagjen U. P plus . nr. .., dhe në këtë objekt ka jetuar deri, në vitin 1994. Pastaj me vendim 07 nr. 360-830 të datës 25.02.1994, paditësi ju ka dhënë përkohësisht në shfrytëzim një podrum me tri dhoma dhe një kuzhinë, në Lagjen U. ./., Hyrja . . Në këtë bodrum pala paditëse ka jetuar, deri me datën 25.02.1994.

Gjykata, bazuar edhe në udhëzimet që kanë rezultuar nga aktvendimi Ac.nr. 1108/2014 datë 19.03.2019, i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, sa i për ketë legjitimitetit të paditurës ka gjetur se të paditurës i mungon legjitimiteti pasive sepse Komuna e Prishtinës është themeluar në bazë të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1244 të miratuara me 10 qershor 1999, e nuk është bartës e të drejtave dhe detyrimeve e vendimeve të marra në vitet kur është marr vendimi si për rrënimin e banesës lëndorë ashtu edhe për ndarjen e banesave nga fondi komunal i banesave. Po ashtu siç është përcaktuar me rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/45 për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë e cila ka hyr në fuqi me 11.07.2000 me çka edhe janë themeluar institucionet e përkohshëm të Kosovës dhe ato në nivel komunal. Me të njëjtën rregullore janë

caktuar të drejtat dhe përgjegjësit e Komunave që në këtë rast Komuna e Prishtinës ka ekzistuar edhe para hyrjes në fuqi të rregullores së lart përmendur mirëpo sipas rregullores së lartë cekur me konstituimin e komunave të pasluftës nuk ekziston kontiuniteti dhe suksesioni juridik për rastin konkret me komunat e para luftës prandaj, për dëmin që pretendohet që i është shkaktuar paditësit me rrënimin e banesës lëndore ku ishte jetuar deri në vitin 1992 dhe mos gjetjen e zgjidhjes për ndarjen e një banese tjetër në Prishtinë siç kërkon paditësi gjykata vlerëson se të paditurës në këtë rast i mungon legjitimiteti pasiv për të qene pale në këtë kontest.

Gjykata vlerëson se paditësi e ka paraqitur si provë aktvendimin për ndarjen e banesës tri dhomshe në shfrytëzim të përhershëm, e cila ju kishte ndarë babait të paditësit tani i ndjerë A. H.. Banesa lëndore e rrënuar siç shihet nga aktvendimi i paraqitur nga paditësi, që gjendet në shkresat e lendes për nevojat e ndërtimit të Kishës Ortodokse në Prishtinë, mirëpo, paditësi sipas Ligjit mbi marrëdhëniet banesore (Gazeta Zyrtare e Kosovës, nr. 11/83, 29/86, 42/86) e aplikueshme në atë kohë sipas rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, është përcaktuar se për të fituar të drejtën e banimit përveç vendimit mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim të prezantuar nga paditësi do të duhej të ekzistoj edhe kontrata mbi shfrytëzimin e banesës dhe një provë shkresor që paditësi është vendosur në banës, e të cilat kushte do të duhej të plotësohen në mënyrë komulative që në rastin konkret paditësi ka dështuar që t'i prezantoj gjykatës edhe në këtë procedure të rigjykimit.

Gjykata, ka vlerësuar edhe pretendimin e paditësit që ka që ka të bëjë me banesën që e kërkon me kërkesëpadi, që e njëjta ti jepet në posedim dhe pronësi, siç ka kërkuar paditësi nëpërmes përfaqësues së tij, në petitum e precizuar të fjalës përfundimtare sipas parashtresës së datës 14.09.2020, mirëpo edhe këto pretendime të paditësit janë në tërësi të pa bazuar në ligji ngase në rastin konkret paditës nuk posedon asnjë bazë juridike të vlefshme për fitimin e të drejtës së pronësisë, siç përcaktohet nenin 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (LTHMPJ – i vitit 1980). Prandaj gjykata përfundimisht vlerëson se paditësit kërkesën e tyre për të drejtën e fitimit të pronësisë në pronën lëndore nuk e kanë provuar me asnjë provë që janë pronarë e madje nuk e kanë provuar me prova shkresore që ka qenë pronarë as paraardhësi i tyre juridik. Paditësit nuk kanë prezantuar prova nga te cilat mund të provohet ekzistimi i fakteve juridike mbi bazën e të cilave fitohet e drejta e kërkuar e pronës sipas dispozitës ligjore të lartcekur, andaj në rastin konkret paditësit nuk e kanë provuar as bazën e as mënyrën e fitimit të pronës në paluajtshmerinë lëndore.

Nga sa u parashtrua më lartë, qartë rezulton se në këtë rast mungon baza faktike me të cilën paditësit i mbështesin kërkesat e tyre, e në mungesë të së cilës mungon edhe baza juridike për aprovimin e kërkesave sepse palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, që në rastin konkret paditësit nuk i kanë prezantuar gjykatës asnjë fakt që do të ndikonte për te vendosur ndryshe në këtë rast, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të neneve 7, 319 dhe 322 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), sipas të cilave dispozita ligjore, barra e provave i përket palës paditëse, si palë aktive në procedurë.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur në kuptim të nenit 452 të LPK-së, që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta.

Andaj duke marrë parasysh të gjitha arsyet dhe dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C.nr.1002/19 datë 24.09.2020

Gjyqtari
Adnan Konushevci

***UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij
aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15
ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet
kësaj gjykate.*

